



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA CITAHOVO
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odseljanje za Opštu Upravu

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Nr. i prot. 2694 Më 30.08.2019
III. RAHOVEC - ORAHOVAO

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.07.2019**, me fillim në ora **10:15**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë, media, dhe ju kuvendarë të nderuar, po ju lexoj rendin e ditës:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i raportit të punës të Kryetarit të Komunës, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2019,
4. Shqyrtimi i raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar - qershor 2019,
5. Informatë nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2018/2019,
6. Informatë nga DSHPS-ja, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2019,
7. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Prokurimit, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2019,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores Komunale për Transparencë Komunale 2019,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës komunale personave fizik dhe juridik,

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I nderuari Kryesues, së pari ju falënderoj që na keni dhënë nga një laptop neve kuvendarëve, që të kryejmë punën tonë në Kuvend. Por desha të propozoj që të na vjen edhe në kopje fizike materiali sepse po gjendemi më mirë, e di që ndoshta po keni pak vështirësi gjatë distribuimit të materialit, por ky propozim është në emër të grupit të PDK-së.

Kryesuesi – I nderuar, arsyetimi i blerjes së laptopave qysh në fillim ka qenë për shkak të kostos së madhe të shpenzimit të letrave dhe problemeve që po na shfaqen gjatë distribuimit të materialit. Por sidoqoftë ne do të kemi parasysh propozimin tuaj. A ka dikush të shtojë diçka sa i përket pikave të rendit të ditës? Nëse jo, atëherë e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se unanimisht është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të jap ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë e vë në votim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pasi që e kemi sot prezent do ja parashtroj një pyetje që ka të bëjë me njërin nga premtimet e tij. Kryetari ka premtuar se do të bëhet vendosja e e-kioskut në oborrin e komunës, pse nuk është vendosur ende edhe sa kohë i duhet që të kryhet kjo punë, ne e dimë që kjo do të lehtësojë mjaftë shërbimet e qytetarëve. Po ashtu desha të them diçka sa i përket incidenteve të shumta që janë duke ndodhur jo vetëm në komunën tonë por në të gjithë vendin, mendoj se ne si komunë duhet të angazhohemi në këtë drejtim duke vendosur pika sa më të shpeshta patrullimi të policëve tanë, dhe me këtë do të mbikëqyrim dhe do të mirëmbajmë nën kontroll trafikun sa më tepër. Pra të mobilizohemi me qytetarë e jo vetëm të shpallim ditë zie, por të respektohen masat të cilat edhe nuk janë duke u respektuar qsa sa duhet.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Desha të ngris një çështje ose një shqetësim rreth degradimit të një pjese të natyrës sonë, fjalën e kam për kanionin e vetëm të lumit Rimnik, që gjendet në pjesën periferike të qytetit të Rahovecit. Dikur kjo pjesë e bukur e natyrës ishte atraksion për larje, peshkim, piknik, kurse tani hedhen mbeturina të natyrës së ndryshme. Kjo pjesë tani është shëndrruar në greminë mbeturinash, në fakt degradimi i kanionit ka filluar me ndërtimin e urës së re për fshatin Drenoc, meqë në këtë rast nuk është marrë për bazë mbrojtja e tij dhe është betonuar një pjesë e madhe. Kërkoj që të ndërmerren masat e nevojshme nga komuna dhe të ndalohet rreptësisht hedhja e mbeturinave, pastaj të mbrohet edhe pjesa e vjetër e rrugës dhe ura Rahovec – Drenoc. Të nderuar në këtë pjesë gjenden edhe disa kroje natyrore të ujit, është mirë të rikthehet ashtu siç ka qenë sepse ka mundësi që kjo pjesë të rikthehet përsëri në atraksion të mëparshëm, si për larje dhe piknik dhe shumë gjëra tjera.

Rasim Fazliu – Desha të ngris një shqetësim që më kanë thënë disa qytetar, ka të bëjë me rrugën kryesore në Rahovec nga stacioni i autobusëve e deri tek qendra, të nderuar, niveli i pushtave në këtë rrugë është shumë në nivelin e asfaltit, kështu që shoferët janë duke ikur nga këto gropa dhe po vie deri tek tollovia në komunikacion. Meqenëse është rrugë kryesore e qytetit dhe frekuentohet më shumë se çdo rrugë tjetër, kishte me qenë mirë që të merren masat dhe të ngritet niveli i atyre pushtave, po ashtu të mbushen edhe disa gropa koxha të mëdha që ishin hapur përgjatë kësaj rruge.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Të nderuar, në mbledhjen e kaluar kam parashtruar një pyetje, ku kam kërkuar që Drejtori i Ekonomisë të na sjellë një raport, por sot nuk jam duke e parë drejtorin dhe shpresoj se do të vie dhe do na sjellë. Pyetja ime për sot është: Ligji i legalizimit për ndërtime pa leje ka hyrë në fuqi në vitin e kaluar, udhëzimi për legalizimin e ndërtimeve pa leje ka hyrë në fuqi me datë: 08.07.2019, pyetja ime është: A keni filluar me trajnimin e stafit për legalizimin e ndërtimeve pa leje? Pasiqë komuna jonë ka 14864 ndërtime pa leje, flas sipas regjistratit të vitit 2016 që e kemi përfunduar në kohën e qeverisjes së z. Idriz Vehapi. Prandaj në emër të grupit të PDK-së, propozoj që të mobilizoheni dhe të filloni sa më parë me legalizimin e ndërtimeve pa leje, sepse ky është interes në radhë të parë i qytetarëve të komunës së Rahovecit si dhe interes i komunës, sepse sipas parallogaritve tona, komuna e Rahovecit nëse e bënë legalizimin e 50% të objekteve brenda 2 viteve,, do i inkasoj rreth 1,200,000.00 €.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam një çështje e cila është duke i preokupuar banorët e gjithë qytetit, mbeturinat nëpër qytet muajve të fundit janë në një gjendje të mjerueshme, kontenjerët dhe vendet afër pikave të grumbullimit janë në një gjendje lirisht mundemi të themi mizerie. Këto ditë koha është shumë e nxehtë, ka rreziqe nga infeksione të ndryshme, prandaj i bëj thirrje të gjitha organeve kompetente që të ndërmarrin masa më të shpejta dhe të zhdukin këtë dukuri. Kurse çështjen tjetër që do e ngris ka të bëjë me ndërtesën e cila gjendet tek rruga “Gëzim Mullabazi”, i nderuari Kryetar banorët e kësaj ndërtese bëjnë thirrje që të bëhet rregullimi i oxhaqeve. Oxhaqet e kësaj ndërtese janë në një gjendje katastrofale, shpesh herë gjatë stinës së dimrit ato janë duke kthyer edhe tym, poashtu ka rrezik edhe për

jetën e qytetarëve. Poashtu edhe kulmi i kësaj ndërtese ka nevojë për renovim, sepse gjatë kohës me shi po depërton uji brenda nëpër banesa e deri tek podrumi.

Rukije Krasniqi - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Desha të ndërlidhem me diskutimin që e bëri e nderuara znj. Besmire Bytyqi. E nderuar kulmi është duke pikur nga ulluqet sepse kulmi është i ri, është rinovuar që një kohë të shkurtër. Ulluqet nuk e përçojnë ujin sepse janë të mbyllur me gjësende që i kanë sjellë shpendët. Po ashtu kam një kërkesë që nëpër shtëpi të kulturës të vendosen kondicioner, sepse gjatë tubimeve që organizohen gjatë verës nuk ke mundësi të qëndrosh brenda nga temperaturat e larta.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të shtroj një çështje sa i përket formës së ndërtimit të pengesave që janë vendosur tek udhëkryqi i palestrës “Mizahir Isma”. Gjithsej janë tre pengesa ose policë të shtrirë, por ka muaj që janë vendosur por ende nuk janë ngjyrosur me ngjyrë, në formën që janë ndërtuar konsiderojmë se janë shumë të vrazhda, dhe shpesh herë kur kalojmë aty pak më shpejtë pëson vetura dhe shoferi. Qëllimi i vënies së tyre është shumë i mirë, por mendoj se aty urgjentisht duhet të ngjyrosen, në mënyrë që ngasësit të kenë parasysh që janë duke ju ofruar një pengese dhe vetvetiu në mënyrë të natyrshme do ta zvogëlojnë shpejtësinë. Poashtu propozoj që edhe një e këtij lloji të ndërtohet tek gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni”, aty është një vend shumë i rrezikshëm dhe i pasiguruar për ngasësit dhe kalimtarët e rastit, por gjithsesi të ndërtohet më me standard dhe të jetë i ngjyrosur me ngjyrë adekuate.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Desha t’i bashkëngjitem kërkesës së kolegut sa i përket pengesave të ashtuquajtura policë të shtrirë, kishte me qenë mirë që të vendosen përballë shkollës fillore “Bekim Sylka”, sepse në këtë rrugë veturat kalojnë me shpejtësi dhe nxënësit janë të rrezikuar.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, siç e dini për arsye të një aksidenti tragjik që ka ndodhur në Rahovec ne si komunë dje kemi pasur ditë zie, fatkeqësisht aksidente të tilla janë duke ndodhur çdo ditë në shkallë vendi, por sa i përket këtij aksidenti unë vetë personalisht kam qenë në vendin e ngjarjes. Ne kemi kërkuar nga policia shtimin e patrullimeve, në rrugët lokale, rajonale, si masë parandaluese që mos të kemi më aksidente të tilla. Edhe pse kemi pak mjete ne e kemi lutur operatorin që të vendosen sa më shumë shenjëzimet si ato vertikale ashtu edhe ato horizontale nëpër ato rrugë që llogariten si pika më kritike. Pajtohem me atë që e tha z. Durguti, por ato ngritje janë bërë me një qellim sa më të mirë, po ashtu kam kërkuar që të bëhet edhe shenjëzimi në këto vende edhe pse operatori është duke hezituar sepse siç e thash nuk kemi shumë mjete, por shpresojmë që shumë shpejtë do ti kemi shenjëzimet në ato tre ngritjet që janë bërë afër palestrës sportive. Po ashtu shumë shpejtë do ti fillojnë punimet për vendosjen e tre parë semaforëve të ri në qytet, një parë semafor të ri do të jenë në vendin që janë, një parë do të jenë tek servisi Teka, dhe një palë tek QKMF-ja, pra kështu e kanë paraparë ekspertët e komunikacionit. Besoj se kjo do t’i ndihmojë qytetarëve që të kenë më pak aksidente, dhe të kemi më pak tollovi në komunikacion. Po ashtu është shumë e vërtetë dhe shumë me vend shqetësimi i z. Rasim Fazliu, kur e tha se pusetat janë në shpërputhje me asfaltin, pavarësisht se janë bërë disa riparime, ne përsëri po kemi vështirësi, por vështirësitë na shtohen neve zakonisht kur po kemi reshje me rrëmbim dhe po kemi përzierje të ujërave atmosferik me ujërat e zeza, pastaj del uji nga ato puseta, po ashtu ka edhe disa gropa të cilat janë krijuar. Ne e kemi një kontratë me një operator për riparimin e rrugëve dhe gropave, por ne kemi hezitimet tona sepse në rrugën kryesore kemi menduar që të bëjmë zgjerimin e rrugës dhe krijimin e parkingjeve të reja. Por para disa ditëve i kam mbledhur inxhinierët dhe arkitektet e komunës së Rahovecit, ku kemi kërkuar një zgjidhje për me e zbutë gjendjen e vërshimeve potenciale në të ardhmen, ku rekomandimi i tyre ka qenë që mos të ngutemi dhe mos të bëjmë ndonjë veprim, por gropat dhe pusetat mundemi që ti riparojmë, edhe pse disa gropa janë riparuar, por kanë mbetur edhe disa rrugë, nga xhamia Kadiri e deri tek stacioni i autobusëve. Degradimi i kanionit të lumit Rimnik, është e vërtetë se ai vend ka probleme edhe me shembjet, ku grumbullohet dheu dhe gurët në atë vend, disa herë kanë ndodhur aktivitete të pastrimit në këtë lumë, po ashtu edhe disa herë jemi sfiduar nga elementi i papërgjegjshëm. Tani në momentin që flasim kjo pjesë është e pastruar, kurse pak më larg gjendet deponia e mbeturinave inerte që e ka vlerësuar Gizi gjerman në kohën e z. Idriz Vehapi, ku pastaj është marrë vendim nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit po në këtë mandat. Tani vetëm sa kanë filluar të hedhen mbeturinat e ngurta ose inerte nga operatorët dhe ekonomitë

familjare, ne po ashtu jemi të mobilizuar që të gjitha mbeturinat qofshin ato inerte, organike apo nga mbetjet shtazore që ti eliminojmë sepse është në interes që të përfitojmë edhe nga granti i mbrojtjes së mjedisit ose i performancës, ku besoj se edhe vitin e kaluar e ka merituar që të jetë fituese e këtij granti sepse renditet ndër komunat më të pastërta në shkallë republike. I nderuari Fehmi Hoxha e ngriti një shqetësim, i nderuar këtu e kem edhe Drejtorinë e Urbanizimit z. Rumir Zhuniqi, i nderuari Fehmi ju keni qenë drejtor po në këtë drejtori, po ashtu keni punuar një kohë në këtë drejtori, prandaj ju kisha lutë që ta shtoni bashkëpunimin me Drejtorinë e Urbanizimit. Ne jemi të interesuar që ta zbatojmë ligjin e ri të legalizimit, sepse natyrisht se do të krijojmë të hyrat nga këto pozicione, prandaj ju sugjeroj që të uleni bashkë me Drejtorinë e Urbanizimit dhe të shihni zbatimin e këtij ligji nëse ka hyrë në fuqi. Sa i përket mbeturinave në qytet, e nderuara znj. Besmire Bytyqi, boll i vështirë në komunikim dhe bashkëpunim ka qenë z. Gani Raba, por mundemi të themi se qyteti i Rahovecit i Rahovecit ka qenë shumë më i mirëmbajtur kur ishte ai në punë se sa tani që ai ka dalë në pension, kjo është një e vërtetë e madhe. Të nderuarin e kamë parë në ora dy të mëngjesit me punëtorë, edhe pse edhe tani janë të njëjtit punëtorë, kurse me gjasë pasi ka dalë z. Gani Raba në pension këta e kanë lëshuar që thonë në lero, prandaj sot në takim i kam thënë edhe drejtorit të Inspektoratit edhe drejtorit të Shërbimeve Publike, nëse vazhdon kështu ne mundemi ta dënojmë edhe ndërmarrjen publike.

Kryesuesi – Ju faleminderit Kryetar, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2019.

Kryetari – Të nderuar para vete keni raportin e punës 6 mujore të zyrës së Kryetarit, Kryetari prezantoi në pika të shkurtra para anëtarëve të kuvendit punën e ekzekutivit, ku i prezantoi punët e kryera si dhe punët të cilët kanë mbetur për tu kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2019.

Fehmi Cena – Kryetari në pika të shkurtra e prezantoi raportin e punës gjashtëmujore, ne e kemi pasur materialin në mënyrë elektronike dhe natyrisht që e kemi elaboruar, është me të vërtetë një raport mjaft voluminoz, po ashtu edhe i qartë. Në këtë raport janë përfshirë të gjitha drejtoritë, janë disa çështje të cilat do të doja t'i diskutoj sot këtu shkurtazi.. Po ja filloj nga njësia e personelit ku janë të përfshirë rekrutimet, konkurset që janë bërë gjatë kësaj periudhe, janë të cekur këtu marrëveshjet me shërbime të veçanta, ku janë të cekur dy konkurse në Drejtorinë e Shëndetësisë, edhe pse aty nuk ceken konkurset për mjek stomatolog, infermier që janë pranuar gjatë kësaj periudhe, nuk e di pse nuk është cekur, por për një roje dhe një pastrues me marrëveshje të veçantë është e cekur, po e përmendi këtë sepse problemi në shëndetësi është tek disa Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe tek Ambulancat e Mjekësisë Familjare, janë duke u ankuar që nuk kanë pastrues/e, pra nuk ka shërbim të pastrimit aty. Është një kompani e cila e bënë pastrimin e objekteve të shëndetësisë në komunën tonë, po nuk e di se a janë të përfshirë të gjitha këto objekte, por përgjegjësit ankohen në çdo mbledhje se nuk shkojnë përfaqësuesit e kompanive që ti pastrojnë objektet e AMF-ve apo QMF-ve. Mendoj se zgjidhja e vetme është ose përmes kompanisë ose përmes këtyre marrëveshjeve të punësohen pastrues qoftë edhe përkohësisht. Te zyrat për përfaqësim ligjor, ceken aty kontestet civile ku komuna është e paditur në 788 raste, kurse komuna ka paditur vetëm në 13 raste, por ajo që dua unë të potencoj është se numri i padive ndaj komunës i kanë rritur gjithashtu edhe rastet e pagave të punëtorëve që shkojnë në pension. Problemi është se në qarkoren e parë buxhetore që e kemi shqyrtuar në njërin nga mbledhjet e kaluara, është cekur aty se nga granti i qeverisë është ndarë një pjesë për paga pas pensionimit për sektorin e arsimit, kurse nuk ceket edhe për shëndetësi. Pyetjet që ju kam bërë rreth kësaj ka qenë më shumë negative, pra nuk kam pasur një përgjigje rreth kësaj pse nuk është ndarë buxhet edhe për punëtorët e shëndetësisë? Ne federata sindikale e shëndetësisë shumë shpejtë e kemi pasur një mbledhje në QKMF në Rahovec, ku ata na kanë thënë se në marrëveshjen mes sindikatës dhe Ministrisë së Shëndetësisë është e ndarë edhe pjesa buxhetore për shëndetësi.. prandaj kërkoj nga ju që të shikoni që në qarkoren e dytë buxhetore të përfshini edhe pjesën buxhetore që i takon edhe punëtorëve të shëndetësisë pas pensionimit. Te Drejtoria për Financa dhe Buxhet do e veçoja pjesën e alokimit të subvencioneve nga qeveria qëndrore në vlerën prej 1 milion euro, për dëmet që janë shkaktuar në bujqësi, është shumë mirë që janë ndarë këto mjete, por siç e dimë ne komisioni kur e ka bërë vlerësimin në teren për këto dëme ka qenë diku rreth mbi 5

milion euro, prandaj kompensimi prej 1 milion euro nga qeveria është një vlerë shumë e vogël. Nuk e mendoj se bujqit tanë duhet të jenë të kënaqur me këtë shumë të të hollave, prandaj mendoj se qeveria i ka mbet borxh bujqve të Rahovecit, siç e dini se shumica e familjeve tona varen prej bujqësisë. Prandaj mendoj se qeverisja komunale duhet të jetë më këmbëngulësve edhe me tutje dhe të kërkoj buxhet shtesë që ti dilet në ndihmë bujqve tanë, sepse siç e dini edhe këtë vit ka pasur dëme në bujqësi. Tek Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë të cekura disa aktivitete dhe disa suksese të cilat unë gjithashtu i vlerësoj, si ndërrimi i dytë në dy Qendrat e Mjekësisë Familjare si në Ratkoc dhe Krushë të Madhe, është shumë mirë kjo që është bërë sepse do të ofrohen shërbimet shëndetësore, pastaj pranimi dy stomatologeve në Drenoc dhe Fortesë, pastaj pranimi i një radiologu specialist, një laborante klinike. Shumë mirë këta që janë pranuar, por është e nevojshme zgjerimi i shërbimeve të tyre, sepse këto shërbime janë në atë gjendje si kanë qenë më parë, radiologu merret vetëm me rentgen, është e nevojshëm që t'i sigurohet edhe ultrazëri, në mënyrë që ai të kontribuojë edhe në atë shërbim që iu nevojitet qytetarëve tanë. E njëjta gjë vlen edhe për laboratorin, pra shërbimi duhet të shtohet pasi është shtuar edhe një mjek laborant, gjithashtu fizioterapeut për momentin janë dy dhe ata punojnë në një zyrë dhe në një ndërrim, mendoj se kjo nuk është në rregull, edhe këtu duhet të zgjerohet shërbimi dhe ata duhet të japin kontribut si dy profesionistë e jo si një. Sa i përket marrëveshjes me Caritas Kosova, i nderuar Kryetar e keni cekur se janë pranuar diku rreth 48 punëtorë dhe me këtë është arritur edhe shërbimi shtëpiak për qytetarët e komunës sonë. Ne e dimë se si ka qenë praktika pranimi të punëtorëve deri më tani, por në të ardhmen pranimi i punëtorëve duhet të bëhet me konkurs ku do të përcaktohen kriteret për pranimin e punëtorëve. Te drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm, ceket se bizneset prodhuese ose 63 % të tyre janë të liruar nga taksat që i kanë ndaj komunës, e ne e përkrahim këtë iniciativë që e ka komuna ndaj bizneseve, por kur është fjala për lirim nga taksa, atëherë duhet të keni parasysh dhe komuna duhet të gjejë format e tjera, në mënyrë që ti sigurojë ato taksa që do të jenë deficit për shkak të liritimit të bizneseve në mënyrë që të hyra të ketë mjaftueshëm. Te Drejtoria për Shërbime Publike, është cekur ndërmarrja publike Stacioni i Autobusëve ku shpjegoni se deri ku ka arritur procedura rreth kësaj ndërmarrje, por unë mendoj se ka ngecur kjo pjesë, edhe pse në fund ceket se është shpallur konkursi për përzgjedhjen e kryeshefit të bordit, mendoj se kjo punë deri më tani është dashur të kryhet, nuk e di pse është zhagitur kaq shumë, ne qysh në pjesën e parë të vitit të kaluar kemi marr një vendim si kuvend për themelimin e bordit për ndërmarrjen publike të Stacionit të Autobusëve. Pyetje ime për ju është kur do të kryhet kjo punë dhe pse ka mbetur deri më tani? Kurse sa i përket Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e keni përmendur shumë e subvencionimit si në sport, kulturë, edhe për OJQ-të që kanë veprimtari sociale dhe shëndetësore, mirë është që është bërë kjo, ne edhe në të kaluarën kemi kërkuar që ata të kenë raportin për punën e tyre në lidhje me shpenzimet që janë duke i bërë, në mënyrë që mos të kemi dyshime se mos keqpërdoret buxheti komunal. Ju faleminderit kjo ishte në pika të shkurta nga unë sa i përket raportit të punës 6 mujore të kryetarit.

Rasim Fazliu – E falënderoj Kryetarin e Komunës që na ka sjellë këtë raport kaq voluminoz, por nëse i krahasojmë faqet e raportit që ka shumë, mendoj se punë ka pak të kryera në territorin e komunës së Rahovecit karshi të gjitha këtyre gjërave që janë të cekur në këtë raport. Mirë do të ishte që krahas raportit kaq të gjerë edhe punë të kishte pak më shumë, shkurt shumë pak jemi duke i dëgjuar zhurmat e makinerive në territorin e komunës së Rahovecit. Është për tu përgëzuar disa projekte që janë financuar drejtpërsëdrejti nga qeveria, dhe këto pak po e zbusin çështjen përndryshe është viti i dytë i qeverisjes komunale, dhe nga do qytetarët janë duke shprehur shqetësime, kemi raste që edhe nëpër dëgjime buxhetore kur kemi qenë qytetarët kanë thënë se ja ku i kemi listat e prioriteteve që i kemi dorëzuar më parë, por asgjë nuk është bërë. Prandaj mendoj se kishte me qenë më mirë nëse ishit mare më shumë me punë se sa të shkruani. Problemet kryesore të qytetarëve janë rreth ujërave të zeza, është interesante se edhe në punimet e kryera nga qeverisjet e kaluara, kanalizimet nuk janë në rregull, nuk e përçojnë ujin mirë, dalin mbi rrugë etj. prandaj mendoj se prioritet duhet të jetë puna e ujit të pijes, kanalizimet dhe qeverisja komunale duhet sa ma shpejtë të mirren me këto gjëra, në mënyrë që të largohemi nga epidemitë e ndryshme etj. Falënderojmë edhe qeverinë qendrore, po ashtu edhe qeverinë komunale e cila është angazhuar për kompensimin e dëmeve të bujqve nga

dëmet e vitit të kaluar, por mendoj se është dashur të ceket shuma se sa deri tani janë kompensuar, pastaj sa kanë mbetur të kryhen, sa janë në shqyrtim etj. po ashtu është bërë mirë që është bërë zona ekonomike dhe që janë mare diku rreth 36 hektar, është mirë të kemi më shumë të dhëna se çka është bërë deri më tani aty si në infrastrukturë ose diçka tjetër në mënyrë që të krijohen sa më mirë kushtet për biznese. Do të ndalem pak tek njësia e auditimit të brendshëm, e di se kjo njësi e ka për detyrë që t'u jep juve llogari sepse është nga zyra e juaj, por ju duhet ta informoni kuvendin rreth punës së njësisë së brendshme të auditimit sepse edhe ata i marrin do rroga të mira, kjo d'u ndihmonte edhe juve por edhe neve si kuvend, sepse më vonë do na vjen raporti i auditorit gjeneral dhe ne do të dimë se çka duhet të hiqet nga aty, në mënyrë që mos vijmë deri tek problemet e caktuara. Pra nuk kemi pasur informacione të mjaftueshme nga njësia e auditimit të brendshëm për vitin 2018 për qeverisjen aktuale. Ceket këtu kompensimi i pagave pas pensionimit, këtu ceket se janë 38 lëndë të cilat e kapin shumën prej 142,000.00 €, desha të iu pyes a keni bërë ndonjë plan të veprimit se si do të zgjidhni këtë çështje, në mënyrë që të gjithë këtyre njerëzve të i kryhet obligimi ligjor i cili ju takon? Sa i përket E –Kioskut ju edhe vetë e pranuat dhe e thatë se është dashur të jetë dhe të funksionoj, por siç po shihet ende nuk është, pra edhe kjo çështje është me vonesë. Pastaj ceket këtu rreth kërkesës së Zyrës Ligjore për hartimin e rregullores për të drejtat e fëmijëve dhe formimi i komitetit konsultativ për persona me nevoja të veçanta, mendoj se duhet të bëhen përpjekje më të mëdha dhe duhet që të angazhohemi më tepër për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta, po ashtu edhe për të rriturit që janë me nevoja të veçanta, pra ti ofrojmë ndihmë dhe shërbime më të mira në mënyrë që të kenë një jetë sa më të mirë. E di që në disa vendbanime të caktuara kemi disa raste ku nuk marrin shërbime nxënësit të cilët i kanë edhe kushtet e vështira, ku nuk ka mjete as që të blejë shkopinjë për ecje ose karrocë, kjo nuk është nga tani por daton moti, prandaj është mirë që sadopak kësaj kategorie t'i ofrohen shërbime më të mira. Desha të ndërlidhem për disa raste që i keni cekur këtu për ndërtimin e karrikave stomatologjike në disa qendra si në Optrushë dhe disa vendbanime tjera, por unë konsideroj se kudo që bëhen është mirë, por kishte me qenë më mirë të ndiqet një renditje p.sh kemi thënë se fshati Xërxë, Ratkoci dhe Krusha janë qendra sekondare, pra është dashur të fillohet nga Xërxa dhe të vazhdohet me vendbanimet e tjera. Do të ndalem pak te reparti i hemodializës, edhe këtu si komunë jeni vonuar si goxha shumë, dy vite kanë kaluar, objekti ka qenë i rregulluar, e kuptoj vështirësitë për sigurimin e kuadrit, por ne jemi vonuar dhe sa më shpejtë që i ofrojmë njerëzve këtë shërbim aq më mirë do të ishte për ta. Pastaj përmendet këtu dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi edhe pse ndoshta nuk varet gjithçka nga ju, por gjithmonë e keni thënë se do të bëhet shumë shpejtë do të bëhet, por mendoj se më mirë është që mos të harxhohen më mjetet sepse nëse nuk kryhet kjo me kohë atëherë e humbë efektin e vet, kishte me qenë mirë që ju si Kryetar Komune të insistoni që këto gjëra viteve tjera të ndodhin sa më herët. Tek drejtorja e Shërbimeve Publike është cekur një shumë e mirë për meremetimin e rrugëve, gropave, por rruga që të qon nga Fortesa për Krushe të Madhe, ajo që më la përshtypje ishte se e keni cekur se keni bërë intervenime, por unë tani erdha nga kjo rrugë dhe besoni se mezi që kam dalë nga kjo rrugë, është e vërtetë që është hedhur një kamion me zhavorr, por sa ka qenë kjo e mjaftueshme.

Kryetari – Ju faleminderit shumë, një debat dhe shqetësime jashtëzakonisht interesante, me këtë do i jap përgjigje z. Fehmi Cena edhe z. Rasim Fazliu. Të nderuar, ne i nisim procedurat, i udhëheqim procedurat e prokurimit kur jemi ne autoritet kontraktues, por nëse bëhet një ankesë atëherë dikush tjetër e merr ligjin në dorë, dhe pastaj ata munden të na sjellin jashtëzakonisht vështirësi. Organi shqyrtues i prokurimit (OSHP) i vonon procedurat dhe nuk lodhen fare për ne, sepse kur kalon lënda te ta atëherë vendimmarrës janë ata. Pra të drejtën për ankesë e ka secili, kurse të drejtën për vendime e kanë vetëm atëherë kur ka ankesë. Të nderuar është vonuar kontrata për shërbime të higjienës, ne si komunë është dashur t'i marrim me konkurse punëtorët ekzistues të kompanisë Zona Park, dhe gati 6 muaj është dashur pagë t'i japim këtyre punëtorëve nga kodi i mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë që të kryhet puna. Tani nga data 11 korrik ka kontrata për shërbimet e higjienës edhe në administratë por edhe në shtëpinë e shëndetit, nuk është se jemi të kënaqur me punën tyre, ju e keni parë edhe në ambientet e mjedisit të komunës, si në Administratë dhe objektet tjera të komunës nuk ka pasur ndoshta as letra të tualetit, kjo e gjithë ka ndodhur sepse ne nuk kemi pasur

kontratë deri më tani, tani kemi kontratë dhe nëse ndodh që mos të ketë pastërti ose diç tjetër ne realisht kemi të drejtë ta sanksionojmë operatorin. Sa i përket kontratës kolektive, i nderuari z. Cena sa e di unë punëtorët e QKMF-së që dalin në pension i kanë marrë pagat jubilarë dhe i marrin pagat jubilarë, çështja kontestuese ndoshta për të cilën ti nuk e ke deri në fund informatën, është se për disa orë mungesë janë duke kërkuar diçka tjetër ata dhe Sindikata e Shëndetësisë e ka paditur dhe ne tani jemi në gjykatë. Kurse i nderuar z. Rasim Fazliu, për sa i takon të sapo pensionuarve të arsimit, ne kemi marrë një pjesë të mjeteve nga granti qeveritar për të mbuluar pagat jubilarë për mësimdhënësit, por sa e di unë lënda është në gjykatë, ka disa gabime që sindikata komunale e arsimit me gjasë ka tentuar që të marr diçka më shumë se sa në fakt ju takon sipas kontratës kolektive, ne nuk jemi pajtuar dhe kemi hyrë në konteste gjyqësore, dhe kjo mundet t'i kushtoj mësimdhënësve që mos t'i marrin këto tre paga jubilarë deri sa përfundon kontesti gjyqësor. Sa i përket qarkores së dytë buxhetore në shëndetësi, meqenëse kontrata kolektive është e nënshkruar në nivel udhëheqësish institucional mes udhëheqësve të sindikatave, qoftë ato të arsimit apo të shëndetësisë, besoj se do të jetë praktik që edhe në vitet në vazhdim të praktikohet kjo praktikë dhe të respektohen kontratat kolektive sepse edhe ne e mbështesim respektimin e saj. Të nderuar 1 milion euro janë ndarë për dëmet në bujqësi, raporti i dëmeve ka qenë 5,750,000.00 €, e kam prezantuar para juve në këtë foltore, ne i kemi marrë 17% të dëmeve pra 1 milion. Mos harroni se qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka kompensuar fermerët, komnatat e tjera realisht kanë bërë telashe sepse qeveria e Kosovës realisht nuk e ka obligim me ligj të bëjë kompensimin, sepse ne nuk paguajmë sigurime bujqësore. Por ky kompensim besoni se ju ka dalë në ndihmë bujqve, po ashtu ekzekutimi i pagesave është bërë në një kohë kur ata kanë pasur nevojë më së shumti. Tani lind pyetja e do të tërhiqemi ne nga kërkesa jonë? Të nderuar neve ato mjete na takojnë dhe ne nuk do të heqim dorë asnjëherë që të marrim edhe pjesën tjetër të kompensimit për fermerët e dëmtuar në vitin 2018, kurse ne jemi tani në fund të pagesave për dëmet e vitit 2018. I nderuari Rasim Fazliu, ne kemi raportin gati të përfunduar sa i përket dëmeve të fundit, nuk ka mundur të jetë pjesë e këtij raporti sepse nuk është ende i përfunduar, por shpresoj se për mbledhje të ardhshme do të jetë i gatshëm dhe do e keni para vete, aty do ti keni se sa është vlera e dëmeve në bujqësi dhe në amvisëri. Sa i përket arritjeve në shëndetësi, bërja e ndërrimit të dytë në QMF-në e Ratkocit dhe Krushës së Madhe, ne në këto vende synojmë edhe ndërrimet e treta me i bë, kurse ndërrimet e dyta AMF-të. Kurse unë e di që fshati Xërxë është zonë më urbane se sa Fortesa, por në Xërxë është AMF-ja, për vete i kisha dhënë prioritet Xërxës për shkak të pozitës që e ka, por sipas ligjit, master planit dhe sipas statutit të QKMF-së, në Fortesë është QMF-ja, pra në Xërxë duhet vetëm një mjek dhe një teknik, kurse në Fortesë duhet të jetë një mjek, një stomatolog dhe sa më shumë teknik., do të shohim se a kemi ndonjë mundësi ligjore që diçka të avancojmë nga AMF-ja në Xërxë. Është e vërtetë se kemi bërë lirim të bizneseve nga taksat, ky është një vendim i Kuvendit të Komunës së Rahovecit në vitin 2017, pse jo, e di që deri në vitin 2021 do të lirohen të gjitha bizneset nga taksat deshëm apo nuk deshëm ne si Kuvend i Komunës. Kurse sa i përket borxheve, të nderuar ekzekutivi ose Kryetari i Komunës nuk ka të drejtë të falë borxhe, nëse ka me falë borxhe ndonjëherë ndokush atëherë ai është vetëm Kuvendi i Komunës. Ne jemi të interesuar që të kemi një standard se nëse vendosim me falë borxhe të reja, sepse pastaj ka mundësi që ata që i kanë paguar me rregull borxhet, të thonë ta kishim ditur që do i falni borxhet nuk i kishim paguar as ne. Të nderuar, ju e dini se suksesin e të gjitha punëve ja dedikojmë qytetarit dhe juve, sepse pa juve as ne nuk mundemi bëjmë asgjë. Sa i përket dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit, të nderuar, edhe këtu ka vonesa në OSHP, tenderi është shpallur me kohë, por ka pasur ankesë në OSHP, dhe tani OSHP-ja e ka vendimmarrjen e plotë, dhe për këtë na ka vonuar, prandaj edhe unë pajtohem nëse nuk ka rend të kontratës atëherë këtë vit mos të bëhet spërkatje, por ta lëmë për vitin e ardhshëm, pse të bëjmë tani kur koha i ka kaluar dhe nuk ka afekt? Sa i përket Hemodializës në fushë të lojës kemi luajtur bashkë, është arritje e mëhershme e qeverisë së kaluar, e kemi shtyrë procesin përpara, e kemi pasur një komunikim jashtëzakonisht intensiv me spitalin rajonal të Prizrenit. Ata na i kanë kërkuar neve disa detyra shtesë, detyra teknike që lidhen me përgatitjet finale për të nisur punën, unë hiq më larg se sot në takimin e mëngjesit jam interesuar dhe kam pyetur se ku jemi. Ka plotë 10 ditë që Drejtori i Shëndetësisë z. Samir Mustafa i ka dërguar spitalit regjional në Prizren që ne jemi gati, por drejtori i spitalit

regjional në Prizren nuk iu është përgjigjur ende, shpresoj se nuk e ka ndonjë lojë, sepse nëse mendon të bëjë lojëra duhet të dijë se me komunën e Rahovecit nuk bëhen lojëra, por ne jemi gati dhe topi është te ata, ata janë përgjegjës sepse ky është nënrepart i dializës së spitalit regjional të Prizrenit. Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ne e paguajmë transportin për fëmijë të hendikepuar ose me aftësi të kufizuara, qofshin ato fizike apo psikike, ne e paguajmë një transport edhe për Pejë, pagesa është simbolike. Kurse shoqatës HAREJA ne këtë vit ia kemi dhënë bukur do mjete, po ashtu i kemi ndihmuar që të fitojnë një program për fëmijët me nevoja të veçanta. Sa i përket E-Kioskut siç e thash lënda është në OSHP, kurse tenderi nga ne është shpallur me kohë, lind pyetja a kemi mundësi me ndiku ne në OSHP? Të nderuar OSHP-ja është institucion i pavarur, bordi i OSHP-së votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ata nuk i japin llogari askujt përveç Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ishte një pyetje rreth Zonës Ekonomike, Zona Ekonomike është shpallur me 22 Qershor të viti 2018, ka edhe një mori të procedurash tjera të cilat kanë të bëjnë me licencimin e zonës, ne jemi në finale të licencimit të Zonës Ekonomike. Licencimi i zonës nënkupton mundësi që të vijnë potenciale mbështetëse nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, të gjitha lejet janë marr dhe besoj se shumë shpejtë do të licencohet, dhe pastaj Ministria e Industrisë dhe Tregtisë e ka obligim ta financoj infrastrukturën e zonës. Sa i përket prioritetëve e dimë se prioritet për ne është uji i pijes. Ne në fshatin Pastasel kemi vështirësi, e pranoj këtë, kemi një komunikim me KRU-Gjakovën, ata na kanë ofruar një projekt me vlerë prej 500,000.00 €, ku i bie që komuna e Rahovecit t'i paguaj më shumë se 200,000.00 €, por ne do të shohim se çfarë zgjidhje do të bëjmë. Nëse ne aty investojmë 500,000.00 € dhe në kohën e z. Idriz Vehapi janë investuar edhe bukur do mjete në këtë pjesë dhe ata po thonë se tani ai gyp nuk është funksional, dhe ankohen te ne se komuna e Rahovecit në atë kohë nuk ka mare leje kur e ka vendos atë gyp në KRU – Radoniqi, të nderuar nuk jam i interesuar që ti qojë dëm asnjë investim, por ne duhet të shikojmë pse nuk është duke funksionuar ai gyp? Ne i kemi bërë disa zgjidhje të vogla për disa lagje të reja që janë krijuar sa i përket ujit të pijes, prandaj mendoj se përveç Pastaselit që kemi probleme në vende tjera nuk e besoj se do të kemi probleme serioze.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për gjithë të pranishmit, desha të diskutoj vetëm sa i përket punës së DKA-së në këtë 6 muor të vitit 2019, ku me të vërtetë është bërë një punë e mirë për këtë kohë. Mua më pëlqejnë shumë investimet që janë bërë nga organizatat e huaja, e sidomos nga Caritasi Zvicran, që ka ndihmuar në projektin e ngritjes së kapaciteteve të edukimit. Është mirë që këto projektet e tilla me programet e ndryshme sidomos të MKLSH-së të iu vije në ndihmë kurikulës për implementim në shkollat e ndryshme si në ato parafillorë, shkolla e mesme e ulët, dhe në shkollën e mesme të lartë, me teknikat e reja të mësimdhënies që ia bëjnë më të lehtë implementimin. Arsyeja është se duke bërë një gjë të tillë nxënësve ja mundësojmë një punë më të lehtë, dhe një atraktivitet më të lehtë gjatë orës mësimore, pastaj besoj se sukseset bindshëm do të jenë më të larta. Kjo nuk është vetëm ide e imja por është ide të cilën e kanë kërkuar edhe mësimdhënësit e tjerë që të pajisen me forma të ndryshme të teknikave të reja të mësimdhënies, sidomos programi i MKLSH-së i disponon këto teknika. Përveç kësaj mësimdhënësve i vije në ndihmë edhe për orë që iu duhen për rilicencim, dhe ky është një program i akredituar, programet e akredituara janë programe valide të cilat njihen nga MASHT-i.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë rreth pikës së tretë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar qershor 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam kënaqësinë që para juve të lexoj Raportin Financiar për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2019. Në këtë raport janë të përfshirë të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare, të cilat kanë ndodhur në Komunën e Rahovecit brenda periudhës gjashtë mujore. Raporti përbëhet nga dy pjesë, pjesa hyrëse dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit, shkurtimisht do ju lexoj raportin faqe për faqe në mënyrë që ju ta keni më të qartë dhe të keni hapësirë që të diskutoni dhe të bëni pyetje. Në faqe nr.4 është një tabelar ku janë të prezantuara të hyrat e rregullta, deri në këtë periudhë kemi një inkasim të të hyrave në total prej 529,224.00 €, nëse e bëjmë një krahasim me përdhën e njëjtë të

vitit të kaluar, do të shohim se kemi një ndryshim pozitiv në vlerë prej 73,099.00 €. Më poshtë në të njëjtën faqe e kemi të prezantuar të hyrat vetanake ndër vite duke filluar nga viti 2013 – 2019, ku shihet se viti 2019 ka qenë viti më i mirë i inkasimit të të hyrave, kurse në tjetrin tabelar e kemi të prezantuar të hyrat në bazë të gjobave të trafikut dhe gjobave të gjykatës, gjobat e trafikut kanë qenë 61,842.00 €, kurse gjobat e gjykatave kanë qenë 6,925.00 €. Në faqe nr. 5 kemi një total të prezantimit të të hyrave dhe kur ia shtojmë të hyrat e rregullta të gjobave të gjykatave dhe të trafikut, atëherë do të shohim se kemi një inkasim të të hyrave me vlerë prej 597, 991.00 €, nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar do të shohim se kemi një ndryshim pozitiv prej 7,865.00 €. Dua të iu jap një informatë se për muajin qershor nuk e kemi në raport të hyrat e gjobave të trafikut dhe gjykatave, ku besoj se me përfshirjen e këtyre dy llojeve të të hyrave do të rritej edhe vlera e të hyrave. Në faqe nr.6 e kemi tabelarin ku janë të prezantuara të hyrat sipas taksave, në këtë do të veçoja taksën e Tatimit në Pronë e cila ka një ndryshim pozitiv prej 52,899.00 €. Pastaj në faqe nr. 8 e kemi një prezantim të realizimit të buxhetit dhe të shpenzimit të buxhetit sipas programeve dhe në kuadër të kategorive ekonomike, në paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe në kapitale. Në faqe nr.9 e kemi të prezantuar një rekapitullim të shpenzimeve të buxhetit së bashku me buxhetin fillestar dhe buxhetin final. në faqe nr. 10 -18, e kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit për mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike, kurse në faqe nr. 119 e kemi një rekapitullim të të gjitha këtyre shpenzimeve për mallra dhe shërbime në bazë të kodeve ekonomike. Në faqe nr. 21 e kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit për komunalin, dhe në fund e kemi të prezantuar raportin e Zyrës së Prokurimit që përmban detajet e veta me elemente përcjellëse si data e nënshkrimit të kontratave, vlera e nënshkrimit të kontratave, vlera e parashikuar dhe elemente tjera përcjellëse.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Raporti financiar për gjashtë mujorin e këtij viti paraqet një gjendje reale qoftë të realizimit të të hyrave, qoftë shpenzimeve të buxhetit, po ashtu konsideroj se është një raport që paraqet pasqyrën e saktë. Drejtori e potencoi se të dhënat nga gjobat e trafikut dhe gjobat e gjykatave mungojnë për disa muaj, ku e dha edhe sqarimin për këtë çështje. Pastaj të hyrat vetanake siç po shihet kanë pasuar rritje ku e përgëzoj gjithë stafin e komunës, dhe shërbyesit civil që kanë treguar një efikasitet dhe performancë të mirë në ushtrimin e detyrave të tyre. Pastaj edhe të hyrat nga tatimi në pronë kanë pësuar një rritje në këtë gjashtë mujor, shpresoj dhe uroj që të rritet ky trend i të hyrave, po ashtu edhe realizimi i buxhetit është në një masë të mirë dhe kjo tregon se është duke u realizuar ashtu siç është planifikuar, dhe në fund besoj se rezultatet do të dalin të mira në raportin financiar vjetor.

Fehmi Cena – Ky raport është gjithëpërfshirës dhe është i qartë dhe i prezantuar në mënyrë tabelare nga drejtorja, janë prezantuar krahasimet në tabele me planifikimin, gjithashtu krahasime me vitin paraprak dhe kjo na jepë qartësi që të përcaktojmë saktësisht se në çfarë niveli është buxheti. Të hyrat janë pozitive, dhe nëse i mbledhim edhe gjobat e trafikut dhe gjykatave na del që të hyrat janë në rregull dhe sipas planifikimit. Do të ndalesha tek krahasimi i të hyrave të rregullta sipas kodeve ekonomike, tek shtylla e fundit. Krahasimi, realizimi, planifikimi, në disa kode është një ndryshim shumë i madh, nuk e di a është në pyetje planifikimi i gabuar apo ndoshta mendohet që në pjesën e dytë të vitit të arrihet një farë barazimi, p.sh. e kemi taksën komunale për leje ndërtimi që është një realizim shumë i vogël karshi planifikimit, pastaj taksa për demolim, në disa raste është edhe 100%, tek taksa të hyrat nga shitja e mbeturinave ku planifikimi ka qenë shumë voluminoz, kurse nuk kemi fare të hyra, pyetja ime është a ka filluar ky shërbim, pastaj taksa e tatimit në tokë dhe mbledhja e borxheve, po na del që planifikimi ka qenë mbi 78,000.00 €, kurse të hyrat janë zero, po ashtu pyetja ime edhe për këtë është a ka filluar tatimi në toka. Po ashtu edhe për objektet që i ka komuna me qira është i caktuar kodi, ku të hyrat nuk janë premtuese dhe mendoj që komuna duhet të angazhohet më tepër që ti mbledhë taksat.

Afrim Limani – Ju faleminderit për pyetje, sa i përket asaj pse nuk kemi të hyra nga taksa e lejeve ndërtimore, këto të hyra janë në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, kjo drejtori i ka dy blloqe ku i lëshojnë lejet. Pra jo që nuk kemi pas të hyra nga lejet ndërtimore por siç ju thash janë përzier me bllokun e lejeve për taksën e inspektimit dhe respektimi i planit urbanistik ku si të hyra kemi 6,000.00 €. Sa i përket taksës për mbeturina, këtë problem e kemi diskutuar edhe vitin e kaluar, kjo taksë nuk është që vetëm te ne nuk

inkasohet, por në asnjë komunë të Republikës së Kosovës, Prizreni ka filluar diçka të bëjë por jo edhe në mënyrë ligjore. Ne e kemi adresuar një kërkesë MF dhe MAP-it për staf shtesë dhe nëse na aprovohet kërkesa, atëherë ne do të fillojmë implementim e kësaj takse. Kurse tatimi në tokë, edhe në raportin e kaluar e kam thënë se në kuadër të tatimit në pronë është edhe tatimi në parcela, ne ende nuk e kemi një raport rreth kësaj por shpresoj se shumë shpejtë do të kemi një pasqyrë të qartë se sa kemi pasur të hyra nga tatimi në parcela, kurse tatimi në tokë fillon nga viti 2020. Të hyrat nga qiraja këtë 6 mujor kemi pasur më pak të hyra, por Drejtori për Ekonomi me stafin e vet është angazhuar dhe brenda këtij muaji ka pasur një shumë të konsiderueshme nga qiraja dhe besoj se deri në fund të vitit kemi me arrit planifikimin 100%.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

5. Informatë e DKA-së për përfundimit e vitit mësimor 2018/2019.

Avni Morina – Përshëndetje të nderuar! Pranë vetes e keni informatën e DKA-së lidhur me përfundimin e vitit mësimor me qenë se viti shkollor ende nuk ka përfunduar. Nëse jeni të interesuar unë mund ta lexoj pjesën e fundit të informatës, e cila nuk ka qenë e paraqitur në mbledhje të KPF-së. Drejtorja Komunale e Arsimit e filloi vitin shkollor 2018-2019 më 3 Shtator 2018 sipas kalendarit të paraparë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Viti shkollor, ndonëse filloi mirë dhe me sukses u përmyll gjysmë vjetori i parë, në gjysmë vjetorin e dytë sikur në të gjitha komunat, edhe në komunën tonë punëtorët e arsimit u hodhën në grevë, e cila u organizua nga SBASHK dhe zgjati për 3 javë të tëra. Po ashtu janë mbajtur gara shkollore si në nivelin lokal po ashtu edhe na nivelin qendror. Ndër kryesoret janë këto: Garat e Olimpiadës Matematike, Garat e Olimpiadës së Fizikës; Garat e kreativitetit dhe mendimit kritik të organizuara nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Garat e ditorisë, të organizuara po ashtu nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilat vazhduan deri në mesin e muajit Korrik. Vlen të theksohen edhe sukseset, por sukcesi më i madh i nxënësve të komunës sonë është vendi i dytë në garën e Olimpiadës Republikane të Fizikës, i nxënësit tonë Selim Krasniqi, nxënës i klasës së 9-ë nga SHFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, i cili pastaj bashkë me ekipin fitues mori pjesë në Garën Evropiane të Olimpiadës së Fizikës që u mbajt në Riga të Letonisë nga 29 Qershori deri më 5 Maj 2019. Po ashtu, në garën e kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik, nxënësit e dy shkollave të komunës sonë, të cilët morën pjesë në garën republikane, zunë vendin e dytë dhe të tretë me shfaqjet e tyre teatrale. Edhe këtë vit mësimor kemi vazhduar me traditën e ndarjes së bursave për studentët e komunës sonë dhe këtë vit është rritur numri i përfituesve të bursave nga 63 studentë përfitues të bursës që ishte vitin e kaluar, në 95 studentë përfitues të bursës në këtë vit. DKA edhe këtë vit po vazhdon me realizimin e projekteve të saj, siç janë projektet për ndërtimin e 3 objekteve shkollore, për ndërtimin e 3 çerdheve, projekteve për ngrohje qendrore në 3 shkolla dhe projektet për drenazhimin dhe hidro-izolimimin e dy objekteve shkollore. Po ashtu, DKA ka kontratë edhe për riparime në shkolla dhe furnizime të shkollave me teknologji informative dhe me libra për bibliotekat shkollore. Pasi në kohën kur po raportojmë ende vazhdon procesi i riprovimeve, ne në DKA ende nuk kemi arritur të nxjerrim raportin e saktë të suksesit të nxënësve të këtij viti shkollor. Statistikat në funde të gjysmë vjetorit të dytë, sipas niveleve, janë këto: Arsimi fillore, klasa e I-V me sukses pozitiv janë 96,78%. Arsimi i mesëm e ulët, klasa VI-IX me sukses pozitiv janë 89,20%. Arsimi i mesëm i lart, klasa e X- XII me sukses pozitiv janë 72,49%. Mungesat e nxënësve të cilët ishin më të theksuara në arsimin e mesëm të lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar në nivel komune janë 10,2% më pak se sa vitin paraprakë. Ka përfunduar afati i parë i regjistrimit të nxënësve në shkolla të mesme, dhe kompletimi i regjistrimit të tyre sipas drejtimeve do të bëhet edhe në afatin e dytë, i cili do të realizohet në gjysmën e dytë të muajit gusht. Po ashtu regjistrim të nxënësve kemi pasur edhe në klasat para fillore dhe klasat e para. Ju faleminderit.

Kryesuesi – Drejtor i nderuar të falënderoj, fjalën ju jap juve kuvendarë të nderuar, nëse keni pyetje lidhur me informatën e DKA-së.

Masar Popaj – Desha të ndërlihem te numri i bursave, drejtori e tha që është rritur numri i bursistëve, prej 63 në 95 që i bie 32 bursa më shumë. Me sa e di në 2018, kemi pasur 63 student që kanë marr 600 € në vit, ndërsa në 2019, kemi 95 studentë duhet që marrin 450 €, ndërsa në vitin 2020 ne mundemi ta rrisim numrin

e bursistëve deri në 200 e nga totali i buxhetit të bursave i cili është 42.000,00 €, mos të ndryshojmë asgjë përveç shumës vjetore e cila ju shpërndahet studentëve. Rritja e numrit të bursistëve këtë vit nuk është punë e cila e vlen që të përshëndetet, pasi që me rritjen e numrit të bursistëve, nga totali, po e zbritni shumën e vlerës vjetore të bursave.

Ali Zhuniqi – Sa i përket bursave, sipas portalit kallxo.com, na del që ka pasur shkelje gjatë procesit të shpërndarjes së bursave. Si pasojë e kësaj ka pësuar një studente, e bija e dëshmorit, e cila i ka plotësuar të gjitha kushte e nevojshme, dhe e cila pasi që është ankuar, ka fituar të drejtën e bursës. Pyetja e dytë ka të bëjë me ndërtimin e shkollës në fshatin Fortesë, pse nuk ka filluar ndërtimi i shkollës? Si dhe çështja e mungesave që e paraqiti drejtori, për ne si subjekt politik është shqetësues fakti i mungesave të nxënësve nëpër shkolla.

Mirjeta Krasniqi – Në mbledhjen e Komitetit për Komunitete kam parashtruar pyetjen drejtuar drejtorit të DKA-së, se a ka Komuna e Rahovecit ndonjë ekip i cili vepron kundër fenomenit të braktisjes së mësimi, ku në atë mbledhje kam marrë përgjigje nga drejtori i cili më ka thënë që Komuna e Rahovecit nuk ka ndonjë ekip i cili vepron kundër fenomenit të braktisjes së mësimi, por më ka premtuar që do të punoj në këtë drejtim, prandaj e pyes drejtorin a ka marrë ndonjë hap konkret për formimin e këtij ekipi. Si dhe çështja e dytë ka të bëjë me informim të shkollave në kohën e organizimit të garave nëpër shkolla. Mendoj që është dashur të informohemi nëpërmjet rrjeteve sociale, gjegjësisht “Facebook -ut” i cili është i hapur në emër të DKA-së së komunës së Rahovecit, sepse në mungesë të informimit shumica e shkollave nuk kanë marrë pjesë në garat e DKA-së.

Fahrije Lushi – E falënderoj drejtorin për informatën, por mirë do të ishte që në raste të mbështetjes së nxënësve në gara ndërkombëtare të ceket shuma e mjeteve me të cilën e ka përkrahur komuna nxënësin pjesëmarrës.

Munib Durguti – E falënderoj drejtorin për informatën e ofruar, e kam një pyetje lidhur me përmendjen e nxënësve, mendoj që do të ishte e rrugës të përmenden të gjithë nxënësit të cilët kanë dhënë suksese në garën kombëtare dhe ndërkombëtare të dijës, pasi që shoh këtu mungesën edhe të disa nxënësve të cilët kanë dhënë suksese të tyre dhe nuk janë përmendur. Mendoj që do të ishte e rrugës që të përfshihen të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim.

Avni Morina – Ju falënderoj të gjithëve! z. Masar Popaj, sa i përket shumës së ndarjes së bursave, është e vërtetë që e kemi zbritur shumën e mjeteve me qëllim të rritjes së numrit të përfituesve të bursave, sepse kemi menduar se më mirë është që të jenë më shumë përfitues meritore edhe pse shuma e bursës do të zbritet në përqindje shumë të vogël. z. Ali Zhuniqi procesi i ndarjes së bursave është zhvilluar nëpërmjet komisionit i cili e ka zbatuar konkursin dhe i cili i ka shqyrtuar kërkesat e të gjithë atyre që kanë aplikuar. Si dhe shkolla e Fortesës nuk ka filluar për shkak të procedurave të prokurimit, është bërë ri-tenderimi i ndërtimit të shkollës në Fortesë. znj. Mirjeta Krasniqi, lidhur me ekipin për parandalimin e fenomenit të braktisjes së mësimi, kemi mbajtur takim me drejtorë të shkollave si dhe zyrën komunale për kthim dhe komunitete në mënyrë që të formojmë një ekip gjithëpërfshirës në nivel të DKA-së. Si dhe çështja e informimit, besoj që drejtoresha e shkollës ku vijon mësimin vajza e juaj ndoshta nuk ka dashur të informohet prandaj është çështja ashtu si është. znj. Fahrije Lushi, nxënësi në gara është përkrahur me shumë prej 1.000,00 €, në raport do ta paraqesim këtë shumë. z. Munib Durguti, jemi krenar me të gjithë nxënësit që e kanë dhënë kontributin e tyre në garë, por nxënësin të cilin e kemi përmendur është veçuar pasi që ka marrë pjesë në gara ndërkombëtare, deri sa të tjerët kanë marrë pjesë vetëm në gara nacionale.

Kryesuesi – Të nderuar, kalojmë në pikën e radhës.

6. Informatë e punës gjashtë mujore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale për vitin 2019.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Të nderuar kuvendarë, pranë vetes e keni informatën e punës gjashtë mujore të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, besoj që keni

pasur kohë të mjaftueshme që ta shfletoni këtë informatë, unë nuk kam diçka më shumë që të shtoj përveç se të shprehi gatishmëri që ti përgjigjem pyetjeve rreth paqartësive eventuale.

Fehmi Cena – Falënderoj drejtorin për këtë informatë, por desha të tërheq vërejtjen te tabela e lindjeve në repartin e maternitetit. Pra kemi 41 lindje në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, një numër shumë i vogël i lindjeve në krahasim me stafin i cili punon aty. Sipas disa raporteve të Ministrisë, del që nëse vazhdohet me numër të vogël të lindjeve rrezikohet mbyllja e këtij reparti, prandaj duhet ti kushtohet kujdes i veçantë kësaj çështjeje. Si qëndron raporti i aplikimit për shërim jashtë vendit, a është drejtoria ajo e cila i dërgon dokumentet pranë Ministrisë, apo është pala e obliguar që vetë ti dërgon? Pyes për shkak të evidencës së drejtorisë për numrin e pacientëve të cilët shërohen jashtë vendit. Te skema sociale jam i interesuar të dijë dy çështje; 1. A bëhet pastrimi i listës së përfituesve të skemës sociale? 2. Pse përfituesit e skemës sociale kërkojnë raport mjekësor, apo pse duhet rasti të jetë i sëmurë, në mënyrë që të fitojnë këtë të drejtë?

Ali Zhuniqi – Sa i takon shumëve të cekur, për ndihmë financiare për shërim jashtë vendit, mendoj që është një shumë kotë e shënuar nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë pasi që për këtë çështje përkujdeset ministria.

Samir Mustafa – I nderuari Dr. Fehmi Cena, shumicën e pyetjeve të parashtruara i keni bërë edhe në KPF gjë në të cilën jam përgjigjur në KPF. Sa i përket ndihmës financiare, z. Ali Zhuniqi, këtu është paraqitur numri i personave të cilët kanë përfituar ndihmë momentale të mjeteve që ndahen nga subvencionet e Kryetarit të Komunës dhe jo për shërim jashtë vendit.

Fehmi Hoxha – I nderuari drejtor, e kam një pyetje lidhur me informatën, QMF në fshatin Hoçë e Madhe a është nën mbikëqyrjen e komunës apo jo?

Samir Mustafa – I nderuari, QMF në fshatin Hoçë e Madhe nuk është nën mbikëqyrjen e komunës.

Kryesuesi – Të nderuar pasi që nuk ka të paraqitur që duan të diskutojnë, kalojmë në pikën e radhës.

7. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Prokurimit për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2019.

Nënkryetari – Të nderuar kuvendarë, në mungesë të ushtruesit të detyrës së Zyrës së Prokurimit, do të provoj që në pikat e shkurta t'iu informoj me raportin gjashtëmujor të Zyrës së Prokurimit. Pra, Zyra e Prokurimit për periudhën raportuese ka zhvilluar gjithsej 35 aktivitete të Prokurimit, ku vlera e parashikuar e të gjitha këtyre aktiviteteve është 5.546.928,00 €. Deri më tani janë lidhur 17 kontrata, vlera e këtyre kontratave është 625.285,00 €, ndërsa 18 aktivitete të tjera janë në procedurë. Personeli i Zyrës së Prokurimit ka prezantuar 441 blerje, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale si dhe mallra e shërbime, ku vlera e të gjitha këtyre është 2.690.189,00 €. Në detaje më të hollësishme nuk do të shkoj pasi që i keni të gjitha të prezantuara në raport, nëse keni ndonjë pyetje, do të mundohem që t'iu përgjigjem.

Ali Morina – Përshëndetje të nderuar! Ajo që më shtyu të marr fjalën është projekti i rregullimit të rrugëve fushore, zbatimi i këtij aktiviteti është paraparë në muajin prill, mirëpo, në këtë raport nuk e keni paraqitur një aktivitet të tillë, prandaj pyes, ky projekt a ka filluar të zbatohet apo gjendet në procedurë të OSHP-së.

Kryetari – Pasi që kemi trashëguar një obligim financiar lidhur me këtë aktivitet, obligim të cilin e kemi paguar në fillim të këtij viti, projekti nuk gjendet në procedurë të OSHP-së por është shpallur tenderi me vonesë, pra në vend që të shpallet siç është paraparë në muajin prill, ne e kemi shpallur në muajin korrik.

Kryesuesi – Ju falënderoj të gjithëve për diskutimin e bërë, kalojmë në pikën e radhës.

8. Shqyrtimi i Draft-rregullores Komunale për Transparencë 2019.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë, Draft-rregullorja në fjalë i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore, ne e kemi dhënë kontributin tonë, prandaj nuk na mbetet asgjë përveç se ta votojmë drejtëpërdrejtë. E vë në votim: Konstatohet se unanimisht është miratuar Draft-rregullorja Komunale për Transparencë 2019. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik.

Artan Asllani – Të nderuar kuvendarë, siç mund ta shihni edhe vetë, në pyetje është prona komunale gjegjësisht, objektet e pronës komunale të cilat gjenden në fshatin Xërxe. Janë disa pronarë të cilët janë duke e shfrytëzuar këto objekte, kontrata e tyre pritët që së shpejti të skadojë, andaj ne jemi të obliguar që me kohë të marrim një vendim për objekte në fjalë. Kërkoj nga ju që ta miratoni këtë Propozim- Vendim dhe kështu të na mundësoni vazhdimin e procedurave të mëtejme.

Fehmi Hoxha – I nderuar, pyetja ime është, këto objekte a janë shfrytëzuar deri më tani, dhe nëse po, atëherë nga kush janë shfrytëzuar, a kanë obligime ndaj komunës, a i kanë shlyer ato?

Artan Asllani – I nderuar z. Fehmi Hoxha, këto objekte janë në shfrytëzim nga dy operatorë, të cilëve ju skadon kontrata, sa i përket obligimeve komunale, të dy operatorë që të gjitha obligimet i kanë të shlyera.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së e përkrahim propozimin e Kryetarit të Komunës, duke e ditur që një veprim i tillë do të kontribuoj në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ali Morina – Edhe ne grupi i AAK-së e mbështesim propozimin e Kryetarit të Komunës, dhe propozojmë që afati kohor i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale të jetë 15 vite.

Rasim Fazliu – Të nderuar edhe ne grupi PDK-së e mbështesim propozimin e Kryetarit.


Kryesuesi – Të nderuar, me qenë se nuk ka të lajmëruar të tjerë, e vë në votim pikën e 9 (nëntë) të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht është aprovuar pika e fundit për sot.

Kryesuesi – Kuvendarë të nderuar, pasi që i kemi shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mbledhjen e sodit e konstatoj të mbyllur, shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e Kuvendit ka përfunduar në ora 14:40

01 Nr. 2694

Rahovec, 30.08.2019

Procesmbajtësi:

Skender Hamza

